



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 28.10.2020

Dokument parlamentar

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021” (në parim)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, në mbledhjet e tij të datës 27 dhe 28 tetor 2020. Mbledhjet u realizuan në platformën virtuale *Webex Meeting (Cisco)*.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Arben PËLLUMBI.

Komisioni zhvilloi 4 seanca për shqyrtimin në parim të projektbuxhetit ku u njoh me projektbuxhetin në tërësi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me projektbuxhetin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Komisioni u njoh me parashikimet e treguesit kryesorë të projektbuxhetit të vitit 2021 nga Ministria e Financave znj. Anila DENAJ dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Mbledhja u zhvillua në datën 27 tetor 2020.

Projektbuxheti i vitit 2021 dhe projektbuxheti afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Pas dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 rënia ekonomike e parashikuar vleësohet në masën -6.1 përqind.

Projektbuxheti 2021 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit dhe ekonomia pritët të rekuperohet dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Ky projektbuxhet synon stabilitet rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik të Shqipërisë. Konkretisht ky buxhet synon:

- Vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë, si: Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, Reforma në administratën publike dhe Reforma e menaxhimit të financave publike.
- Investimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- Shpërndarjen në mënyrë më të drejtë të barrës fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.
- Uljen e nivelit të deficitit buxhetor deri në 2.3% të PBB duke përmbushur objektivin madhor për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

- ***Të ardhurat***

Parashikimi i të ardhurave për Buxhetin e vitit 2021, është bazuar në vlerësimin e faktorëve kryesorë me ndikim në buxhet, veçanërisht situata ekonomike krijuar nga pandemia Covid 19 përfshirë efektin e politikave të reja fiskale me qëllim rimëkëmbjen e ekonomisë. Për vitin 2021, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 479 miliard lekë, nga këto, të ardhurat tatimore 437 miliard lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 311 miliard lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 99,7 miliard lekë. Të ardhurat gjithsej të buxheti të shtetit për vitin 2021 pritët të rriten 10.6 %.

Elementët kryesorë që janë faktorizuar në parashikimin e të ardhurave janë:

- rritja nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem.
- kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun;
- çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare;
- sasi të pritshme të importit të mallrave.

- **Shpenzimet**

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2021 janë rreth 587.6 miliardë lekë ose 34.9% e Produktit të Brendshëm Bruto.

Prioritet në Buxhetin 2021 mbetet mbështetja e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si skema e fermerëve, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe zhvillimi i sportit, si dhe një fond prej 1 miliardë lekësh në formën e skemës së mbështetjes së fermerëve përmes përjashtimit të karburantit për prodhim bujqësor nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit.

Në planifikimin e investimeve për vitin 2021 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Në vitin 2021 do të vazhdojë të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre.

Konkretisht, Investimet Publike për vitin 2021 janë planifikuar në masën 120.6 miliardë lekë, duke përfshirë edhe fondin e rindërtimit në shumën 27 miliardë lekë.

- **Defiçiti buxhetor**

Defiçiti buxhetor për vitin 2021 planifikohet të jetë në nivelin 6.5% të PBB. Balanca primare edhe për këtë vit pritet të jetë sërish negative në rreth -3.9%, por më mirë se në vitin aktual. Megjithatë, balanca korente fiskale rikthehet në shifra pozitive në vitin 2021, në nivelin prej 0.8% të PBB-së nga një nivel i pritshëm negativ prej -0.3% këtë vit, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal.

- **Borxhi publik**

Borxhi publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Pavarësisht nevojave për hua në rritje të krijuara nga pandemia COVID-19, huamarrja gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 ka arritur të përmbush plotësisht nevojat buxhetore, si edhe të gjitha nevojat që burojnë nga detyrimet e borxhit ekzistues. Në këtë drejtim vlen për t'u përmendur emetimi me sukses i Eurobond-it me vlerë 650 milion Euro në tregjet ndërkombëtare, i cili përveç se plotësoi nevojat për likuiditet, përçoi një sinjal pozitiv përsa i përket aftësisë për të siguruar fonde dhe qëndrueshmërisë së financave publike në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2020, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga tërmeti i muajit nëntor 2019 dhe përhapjes së pandemisë Covid-19, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostos.

Nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rfinansimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet, ndërkohë që nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në mbledhjen e datës 28 tetor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Bledi Çuçi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i vitit 2021 në terma financiar është rreth 12.8 mld lekë. Ministri u shpreh se buxheti i akorduar për këtë ministri, duke marrë parasysh vitin e vështirë që po kalojmë, është mjaft i mirë dhe është rritur me rreth 20%.

Ky buxhet shënon një përmbushje të disa objektivave strategjike të sektorit të bujqësisë, ku më të rëndësishmet renditen:

1. Me fondin prej 1 miliard lekësh, realizohet premtimi për subvencionimin e naftës për fermerët. Parashikohet të mbulohen nevojat e rreth 70,000 fermerëve.
2. Përmbillet Reforma Veterinare, duke krijuar Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, ku i shtohen sistemit 430 punonjës të rinj. Matrikuj dhe shërbim falas për blegtorët. Kjo përbën fondin me rritjen më të madhe në përqindje krahasuar me 2020 ose 88% më shumë.
3. Vazhdojnë investimet në forcimin e institucioneve të sigurisë ushqimore ISUV dhe AKU. 100 milionë lekë shtesë ose 74% më shumë se viti 2020.
4. Rritet financimi i brendshëm dhe i huaj për programin IPARD, Projektin e GIZ-it dhe fondi i garancisë BERZH, me rreth 480 milion lekë.
5. Fillon projekti madhor për rindërtimin e 3 porteve të peshkimit në Durrës, Vlorë dhe Shëngjin nga kredia italiane prej 25 milionë euro.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mësipërme sipas programeve të mëposhtme:

- **Zhvillimi rural dhe mbështetja për fermerin**

Programi Zhvillimi Rural, ku përfshihen edhe skemat mbështetëse të fermerëve me subvencione ka një rritje të buxhetit me 29% krahasuar me 2020 dhe shkon në 5,2 miliardë. Në këtë program përfshihet edhe shpërndarja e naftës pa detyrime fiskale për përdorim në bujqësi për fermerët, duke subvencionuar me 1 miliard lekë këtë skemë.

Skema kombëtare parashikon një rritje të mbështetjes për fermerët me thujse 58% ose një vlerë prej 804 milion lekë, duke parashikuar vijueshmërinë e mbështetjes për masat e aplikuara edhe gjatë këtij

viti me qëllim konsolidimin e mbështetjes për sektorët prioritarë si blegtoria, prodhimi në sera, bletaria dhe certifikimi i standardeve të prodhimit.

Vijon programi IPARD II, si dhe parashikohet mbështetja me incentiva të reja nga Fondi i Garancisë me BERZH, si granti në vlerë 10% të shumës totale të kredisë së lëvruar për agrobiznesin dhe turizmin, sektor i cili parashikohet të përfshihet në këtë instrument, duke konsideruar efektet e krizës COVID në këta sektorë.

Për herë të parë, është planifikuar realizimi i një nisme e cila synon ngritjen e një sistemi monitorimi dhe informimi agro-meteorologjik me qëllim menaxhimin e risqeve në bujqësi, që burojnë nga ndryshimet klimaterike. Ky projekt parashikon një vlerë totale prej 250 milionë lekësh.

Megjithatë kërkesat shtesë për këtë program janë për 5 miliardë lekë, nga të cilat 1,3 miliardë i kërkon programi IPARD për të plotësuar financimin e kërkesave për 2021, si dhe ato të mbartura nga 2020.

- **Siguria Ushqimore**

Nëpërmjet programit “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla duke ulur në këtë mënyrë numrin e kafshëve të prekura nga Bruceloza, nga plasja dhe nga tuberkulozi.
- Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar.
- Mbatjes së një fondi për emergjencat veterinare dhe emergjencat për sigurinë ushqimore. Ky zë përdoret në rastet e shpërthimit të sëmundjeve ose epidemive të cilat janë të pa parashikueshme.
- Rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksport nga 25 në vitin 2020, në 40 në vitin 2022.
- Rritjes së numrit të operatorëve që aplikojnë standardet HACCP në sigurinë ushqimore nga 1100 në vitin 2020, në 1200 në vitin 2022.
- Numri i sëmundshmërisë së njerëzve nga kafshët ka ardhur në zbritje, kjo si pasojë e realizimit në kohë e vaksinimit të kafshëve. Nga 80 njerëz të prekur në vitin 2020 nga sëmundjet zoonotike (transmetimi i sëmundjes nga kafsha te njeriu), në 60 njerëz të prekur në 2022.

Buxheti për këtë program është 2,1 miliardë lekë dhe ka një rritje prej 42%

Shërbimi Veterinar

Rritja më e madhe shkon për të mbështetur reformën në Shërbimin Veterinar, ku buxheti parashikon futjen në shërbimin kombëtar të veterinerëve me 430 veteriner të rinj, me fond pagash me rritje 88%.

Me miratimin e reformës në Shërbimin Veterinar, do të arrihet kapilarizimi i shërbimit dhe kontrollit më të mirë të shëndetit të kafshëve.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Gjatë vitit 2021 do të zgjerohet ISUV-i me 2 sektorë të tjerë (Sektori i Aditivëve dhe ngjyruësve dhe Sektori i Mbrojtjes së Bimëve), të cilët i vijnë drejtpërdrejt në ndihmë ristrukturimit të sistemit të sigurisë ushqimore në vend.

Ndërkohë parashikohet të investohen 60 milionë lekë për rikonstruksionin e ndërtesës ekzistuese të ISUV-it, si dhe 30 milionë lekë për blerjen e pajisjeve të reja për laboratorët e sigurisë ushqimore, duke garantuar standarde evropiane. Po kështu do të mirëmbahen 95 testet e akredituara dhe do të zhvillohen 27 metoda të reja duke rritur kapacitetet analitike dhe numrin e shërbimeve.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Ministria ka në fokus ristrukturimin e AKU-së, për të krijuar mundësinë që ky institucion të përmbush me sukses misionin që i ka dhënë ligji dhe të fitojë vitalitetin e institucioneve simotra të vendeve evropiane.

Do të investohet për blerjen e pajisjeve laboratorike, pajisjeve për trupat e inspektimit, si dhe rikonstruksionin e ndërtesës të Drejtorisë të Përgjithshme të AKU, dëmtuar pas tërmetit.

Me qëllim optimizimin sistemeve të informacionit, transparencën dhe monitorimin e inspektimeve, do të realizohet kryerja e procedurës së inspektimit on-line në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK), nje nervalgjike për garantimin e sigurisë ushqimore për konsumatorët.

- **Peshkimi**

Ky program ka edhe rritjen më të madhe të buxhetit për vitin 2021 krahasur me programet e tjerë. Rritja është 201%. Politikat që do të ndiqen në kuadër të këtij programi janë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE dhe të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Me rëndësi është fillimi i projektit madhor për rindërtimin e 3 porteve të peshkimit në Durrës, Vlorë dhe Shëngjin me financim nga kredia italiane prej 25 milionë euro. Do të vijojë gjithashtu mbështetja për ngritjen e infrastrukturës së markatove të peshkut nëpër porte, ku është planifikuar përfundimi i ndërtimit dhe funksionimit të markatos së peshkut në Vlorë.

Instrumenti i radhës në ndihmë të sektorit të peshkimit është edhe program i granteve të financuara nga BE për rinovimin e pajisjeve të anijeve të peshkimit, me vlerë 1,5 milion euro.

Gjatë vitit 2021 është parashikuar programi i ripopullimit me rasate për rritjen e rezervave peshkore i liqenit të Fierzës, Ulzës e Shkopetit, Ujëmbledhësi i Bovillës dhe Liqeni Artificial i Tiranës.

Me anë të këtij buxheti do të financohen përafrimi i standardeve ndërkombëtare (EU, ICCAT, GFCM)

- **Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit**

Buxheti i vitit 2021 për këtë program shkon në 3,7 miliardë dhe ka një ulje me 10% krahasuar me vitin 2021. MBZHR me buxhetin në dispozicion do të vazhdojë ndërhyrjet me investime në zonat më problematike. Gjatë vitit 2021 është parashikuar:

1. Rikonstruksioni i Argjinaturës së Selevcit, Bashkia Vlorë, me vlerë të plotë rreth 192 milion lekë dhe financuar në dy vite 2021-2022.
2. Rehabilitim i kanalit ujitës, krahu i djathtë rezervuari Gjanç në Korçë, me vlerë të plotë rreth 90 milion lekë dhe financuar në dy vite 2021-2022.
3. Investime për mbrojtjen nga përmbytjet e lumit Drin në zonën e Bërdicës, fshati Rreth i Epërm, Shkodër. Vlera 95 milionë lekë.

Ndërsa projekti për mbrojtjen nga lumi Fan është thuajse në përfundim me një vlerë të përafërt prej 86 milion lekë.

Gjithashtu vazhdojmë financimin e objekteve vaditëse të bashkive duke i përmbyllur investimet e nisura në vitin 2020.

Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes (financim i BB), për përfundimin e rehabilitimit të skemave ujitëse, projekt që përfundon në muajin maj 2021. Për financimin e plotë të tij duhen shtesë edhe 385 milion lekë financim i huaj dhe 205 milionë lekë financim i brendshëm (TVSH+KL).

- **Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i njohurive të fermerëve dhe agrobizneseve duke ofruar asistencë teknike falas me qëllim përmirësimin e produktivitetit bujqësor.

Për këtë aspekt shumë të rëndësishëm të bujqësisë dhe zhvillimit rural, rritja e buxhetit të vitit 2021 është 17%. Për realizimin e këtij qëllimi puna do të përqëndrohet në:

1. Ofrimin e 60 kartave dhe paketave teknologjike me elementë të përmirësuar të cilat synohen të adaptohen dhe aplikohen prej rreth 86,000 fermerëve.
2. Informimin dhe asistimin e 294,000 fermerëve nga strukturat e ekstensionit në 4 AREB
3. Trajnimin çdo vit të 225 specialistëve stafit të 4 AREB-ve.
4. Asistimin e fermerëve aplikues në skemat kombëtare dhe IPARD.
5. Informimin dhe trajnimin e rreth 1300 grave.

6. Realizimin e 124,600 mijë lekë të ardhurave nga aktivitetet dytësore të bazat prodhuese në 5 QTTB-ve.
7. Përmirësimin e kushteve të punës në 5 QTTB-të dhe 4 AREB për realizimin e detyrave funksionale me cilësi dhe në kohë përmes projekteve të investimeve në vlerën 76 milion lekë.

- **Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore**

Për këtë zë është parashikuar rritje e buxhetit me 33%

1. Në vitin 2021, informacioni për tokën (LIS) dhe integrimi në GIS do të realizohet në rreth 20 mijë ha tokë bujqësore, me një buxhet prej 27 milion lekë, në qarqet Durrës, Lezhë, Shkodër dhe Korçë;
2. Për vitin 2021, synohet ngritja dhe funksionimi i programit “Web GIS” publik, që do të ofrojë informacion online mbi tokën bujqësore si dhe do të mundësojë përdorimin dhe përditësimin e informacionit nga institucionet kompetente;
3. Dixhitalizimi i Regjistrat të Tokës Bujqësore do të vazhdojë për 3 vite në 12 njësi administrative vendore dhe kryesisht do të fokusohet në zonat ku është mbledhur informacioni mbi tokën (LIS) dhe integruar në GIS. Për çdo vit pritet që të dixhitalizohen regjistrat për 4 njësi administrative. Numri i regjistrave që do të dixhitalizohen janë ulur në raport me vitet paraardhës për shkak të mungesës së regjistrave të plotësuar manualisht nga njësitë administrative apo Bashkitë.

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2021 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u përqëndruan kryesisht në:

- funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture nga pushteti vendor në zona të ndryshme;
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët dhe ndërtimin e tregjeve për grumbullimin e produkteve bujqësore;
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët për heqjen e taksës së karbonit për karburantit që përdoret në bujqësi
- dokumentacioni i domosdoshëm për përfitimin nga skemat e mbështetjes së fermerëve;
- peshkimin dhe ecurinë e tij, duke u fokusuar kryesisht tek tregjet e peshkimit;
- forcimin e kontrollit për sigurinë ushqimore në të gjitha aspektet e saj dhe forcimin e institucioneve që lidhen me të;
- përfitimi i fermerëve në zona të ndryshme për blegtorinë; etj.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mbledhjen e datës 28 tetor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri z. Blendi Klosi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2021 do të jetë rreth 2.22 miliardë lekë dhe në tërësinë e tij, shënon një rënie krahasuar me një vit më parë.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme si:

- **Zhvillimi i turizmit**

Në fushën e Turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë.

Ministri Klosi sqaroi deputetët se ky sektor ka pësuar një goditje shumë të rëndë nga situata me Covid 19 dhe për këtë vit mbijetesa e tij është përballuar vetëm nga shqiptarët qofshin ata vendas apo të rajonit.

Prioritetet për periudhën 2021-2023 për sa i përket turizmit vazhdon të mbetet diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor.

Janë hapur disa kantiere siç është ai i hotelerisë në turizëm dhe kërkohet promovimi i turizmit shqiptar nga Ministria në mënyrë që të jenë në funksion të rritjes ekonomike.

Filozofia e Ministrisë është që bregdeti shqiptar të promovohet si bregdeti i të gjithë rajonit.

Me përfundimin e rrugëve komplementare të Rruges së Kombit dhe me fillimin e investimeve në infrastrukturë të cilat lidhin zonat e ndryshme turistike, ka ardhur koha të përgatitemi për një sezon turistik që të rrisë numrin e turistëve nga jashtë.

Mbështetja për agroturizmin që është dhënë nëpërmjet politikave dhe ligjëbërjes, ka sjellë një rezultat shumë të mirë në këtë sektor.

Përsa i përket politikave të diskutuara tashmë dhe më parë gjatë shqyrtimit të ligjeve me Komisionin, Ministri sqaroi se nuk ka indikatorë të ngecjes së zhvillimit të këtij turizmi, por pandemia Covid – 2019 ka shkaktuar pengimin e lëvizjes. Megjithatë me rifillimin e lëvizjes pritet që edhe ky sektor i turizmit të ketë zhvillime pozitive. Janë miratuar projekte për investime në porte private.

- **Mjedisi**

Për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Prioritet për mjedisin janë programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Objektivat kryesore për mjedisin fokusohen në:

- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2022 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura;

- **Ministri kërkoi nga deputetët që në kuadër të ndjeshmërisë së deputetëve ndaj çështjeve mjedisore, të shihet mundësia për një mbështetje për rritje të fondeve për rritjen e kapaciteteve monitoruese dhe mbikqyrëse në fushën e mjedisit me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Bashkimit Europian.**

- **Për sa i përket zonave të mbrojtura, tashmë kanë përfunduar hartat e tyre dhe po bëhet transformimi i tyre si zona turistike por duhen fonde për promovimin e tyre si destinacione të tilla. Për këtë ka nevojë për buxhet, pavarësisht se pandemia nuk ka lejuar zhvillimin e shumë aktiviteteve, megjithatë ato janë zhvilluar në natyrë nëpër këto pika.**

- **Përsa i përket pyjeve, në zbatim të ligjit të ri për pyjet, është ngritur Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe po ngrihen degët e saj rajonale, por kontributi i pyjeve në ekonomi akoma nuk është aty ku duhet dhe ka shumë nevojë për një kontribut më të madh të pushtetit vendor, pasi ata janë pronarë të pyjeve por nuk është angazhimi i duhur nga ata sa i përket investimeve. Pra mungon angazhimi i tyre për t'i kthyer në një ekonomi të mirëfilltë.**

- **Gjithashtu, deputetët u shprehën për rritjen e fondeve për përmirësimin e monitorimit të ajrit urban si një nga elementët që ndikon shumë në qytetarët e zonave urbane kryesore, kur është e provuar shkencërisht edhe korelacioni mes ndotjes së ajrit dhe rritjes së vdekshmërisë si pasojë.**

- *Diskutimet në Komision*

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2021 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, u përqëndruan kryesisht tek:

- Cilësia e ajrit në zonat urbane dhe monitorimi i tij;
- mbrojtja e mjedisit dhe promovimi e ndërgjegjësimi i publikut për të;
- ecuria e administrimit të pyjeve, monitorimi i moratoriumit dhe nevoja për lëndë drusore në disa zona të caktuara, si dhe monitorimi i tregut të druve të zjarrit;
- strukturat e mbikqyrjes së pyjeve dhe pyllëzimet e reja apo strategji për këtë, dhe bashkëpunimi me bashkitë për përmirësimin e menaxhimit të kësaj pasurie kombëtare;
- ambiciet dhe pritshmëritë që ka ekonomia shqiptare nga sektori i turizmit;
- investimi në ingrastrukturë, menaxhimi dhe mbikqyrja e zonave të mbrojtura dhe promovimin e tyre si atraksione turistike dhe ndërhyja e nevojshme në disa prej tyre siç është ajo e Syrit të Kaltër;
- sigurimin e fondeve për mbështetjen e mjedisit dhe për projektligjin për ndryshimet klimatike;

- ecuria dhe mbështetja e turizmit; etj.

Komisioni, u shpreh që buxheti i akorduar për turizmin dhe mjedisin është modest dhe nuk reflekton mbështetjen që duhet të kenë këta dy sektorë. **Deputetët u shprehën se kjo ministri duhet mbështetur për rritjen e fondeve buxhetore në dispozicion më qëllim përmbushjen e objektivave të saj dhe realizimin e pritshmërive të publikut ndaj turizmit dhe mjedisit.**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mbledhjen e datës 27 tetor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Belinda Balluku dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Orientimet kryesore të buxhetit 2021 e në vazhdim, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zhvillimi më tej i sistemit kombëtar të transportit, përmirësimi i ndjeshëm i qëndrueshmërisë, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integritit të tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes një portofoli të investimeve publike; dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2021” i akordon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një buxhet total në vlerën 49.3 miliard lekë. Konkretisht, për vitin 2021 ka një rritje të buxhetimit në total prej 4.2 miliard lekësh në raport me tavanet buxhetore të fazës së dytë të PBA 2021 -2023 të përgatitura në shtator 2020, dhe një rritje prej 3.3 miliard lekë krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2020. Por, ky buxheti vitit 2021 mbulon vetëm 45% të nevojave reale të kërkuara nga MIE, synon të përmbushë objektivat e mëposhtme sipas fushave:

- **Energjia**

Ky program konsiston në krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshme dhe të sigurt të sektorit të energjisë, në zbatim të programit dhe prioritetëve të Qeverisë. Politikat do të përqendrohen në realizimin e detyrave në zbatim të

Traktatit për Krijimin e Komunitetit të Energjisë veçanërisht lidhur me ristrukturimin e tregut të energjisë duke bërë plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në sektorin energjetik në përputhje me *acquis communautaire*; garantimin e një furnizimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të ekonomisë me burime energjetike, krijimin e kushteve të përshtatshme për përdorimin e energjive të rinovueshme, rritjen e efikasitetit të energjisë, nxitjen e zhvillimit të tregut të gazit natyror, mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin eficient të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.

Mbështetja për energjinë do të vazhdojë edhe këtë vit. Objektivat kryesore janë si më poshtë:

- Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale;
- Diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet dhe përmirësuar arkëtimet dhe likuiditetet;
- Në vitin 2021 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2020;
- Në vitin 2021 do të rritet efikasiteti i energjisë me 6.5% referuar vitit 2020.

Ky program është buxhetuar në total 3.2 miliard lekë dhe plotëson të gjitha nevojat e parashikuara, por Ministria sqaroi deputetët se për Agjencinë e Eficencës së Energjisë kërkohen shpenzime korrente mbi tavanin e miratuar pasi ky institucion është në proces të miratimit të strukturës së re.

Kërkesa është për një rritje e tavanit të shpenzimeve korrente me me 64.5 milion lekë.

- **Infrastruktura**

Transporti rrugor

Ky program mbulon me financim zgjerimin, rritjen e standarteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, përfshirë korridoret dhe rrugët për në destinacionet kufitare dhe turistike, me synimin e krijimit të një transporti të qëndrueshëm që nënkupton uljen e kostos, rritjen e shpejtësisë së lëvizjes, sigurinë rrugore dhe atë fizike të mjetit, udhëtarit dhe ngarkesës si dhe parametra të pranueshëm mjedisorë.

Si objektiva kryesore mund të rendisim sa më poshtë:

- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.
- 3483 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;

Ky program është buxhetuar në total 26.2 miliard lekë ndërsa nevoja reale për përmbushjen e tij llogaritet në 60.5 miliard lekë.

Ministria, sqaroi deputetët se mungesa e financimit në politikat ekzistuese, projektet e të cilave mbylleen në vitin 2020 dhe 2021, do të rrisë ndjeshëm rrezikun për krijimin e detyrimeve buxhetore

përgjatë vitit 2021 në programin e transportit rrugor, ndërkohë që për vitin buxhetor 2020 do të përmbillet me një performancë shumë të mirë të shlyerjes së këtyre detyrimeve.

Për realizimin e këtij programi kërkohen edhe 12 miliardë lekë të ndarë si më poshtë:

- **rritje e tavanit buxhetor në shpenzimet korrente me 2 miliard lekë për të mbuluar nevojën reale të mirëmbajtjes së rrugëve;**
- **rritje e tavanit të shpenzimeve kapitale me të paktën 10 miliard lekë për të mbuluar financimin e projekteve ekzistuese që përmbillen në vitin 2021.**

Transporti ajror

Ky program po merr përparësi si një ndër fushat që do të sjellë një zhvillim të konsiderueshëm infrastrukturor e ekonomik për vendin. Tashmë ky program nuk do të mbështetet vetëm në mbulimin e disa shpenzimeve administrative për institucionin e OKIA-s, por merr një dimension të ri, atë të zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara.

Si objektiva kryesorë mund të rendisim sa më poshtë:

- Rritja e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;
- Numri i investigimeve të kryera në vitin 2023 të arrijë në 5 nga 4 investigime që pritet në 2020;
- Zbatimi i standarteve të njehësuar të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

Ky program është buxhetuar në total 140.3 milion lekë dhe llogaritet se i plotëson pothuajse të gjitha nevojat.

Transporti Detar

Ky program mbulon me financim projekte të investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Si objektiva kryesorë mund të rendisim sa më poshtë:

- Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integritimit në BE;
- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave në porte në masën 40% në vitin 2023 nga 25% që është aktualisht në 2019

Programi për transportin detar është buxhetuar në total 155 milion lekë nga nevoja reale që llogaritet 534 milion lekë dhe plotëson vetëm 30% të nevojave.

Ministria sqaroi deputetët se në funksion të përgjegjësive të saj, MIE në kuadër të detyrimeve ndaj organizmave ndërkombëtare ku aderon, ka propozuar kërkesa shtesë për projekte të cilat lidhen drejtpërdrejtë me sistemet e menaxhimit të sigurisë në porte.

Konkretisht, kërkohet një shtesë fondesh si më poshtë:

- **Shtesë tavani buxhetor me të paktën 200 milionë lekë për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për projektet e propozuara që nuk janë marrë parasysh në projektligjin e buxhetit;**
- **Shtesë tavani të shpenzimeve kapitale me financim të huaj me të paktën 10 milion lekë lekë.**

Transporti Hekurudhor

Ky program ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor.

Programi për transportin hekurudhor është buxhetuar në total 2.1 miliard lekë dhe plotëson 100% të nevojave.

Objektiva kryesore të këtij programi janë si më poshtë:

- Rikonstrukcioni i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas;
 - Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore; Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente të reja dhe ekzistuese hekurudhore.
- **Mbetjet urbane**

Ky program mbulon me financim nga shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale projektet në fushën e mbetjeve urbane si dhe inceneratorët në ndërtim

Objektivat kryesore për trevjeçarin janë si më poshtë:

- Në vitin 2023 synohet që të trajtohen rreth 50% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve, nga 30% që parashikohet në fund të vitit 2019;
- Norma e ndotjes së ajrit synohet të arrihet në 39 µg/m³ në 2023 nga 45 µg/m³ që pritet të arrihet në fund të 2019;
- Norma e mbetjeve të rikuperuara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synohet të arrihet në 30% në 2023 nga 3% që synohet në fund të 2019;

Ky program është buxhetuar në total 3.2 miliard lekë dhe plotëson pothuajse të gjitha nevojat.

- **Furnizim me ujë dhe kanalizime**

Ky program financo projektet të hartuara në përputhje me prioritetet e qeverisë për reformën e ujit, mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjinë Sektoriale, Programin Kombëtar Sektorial, grupi “Uji për njerëz” dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Objektivat e këtij programi janë si më poshtë:

- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2023;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2023.
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar nga 12.1 orë në vitin 2013 në 20.5 orë në vitin 2023. (për vitin 2021 18.1 orë)
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat Urbane nga 11 orë në vitin 2013 në 23.1 orë në vitin 2023. (për vitin 2021 21.5 orë)
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Rurale 62% në vitin 2023 nga 59% në vitin 2019;
- Mbulimi me kanalizime zonë Urbane 81% në vitin 2023 nga 80% në vitin 2019;
- Mbulimi me kanalizime zonë Rurale 22% në vitin 2023 nga 16% në vitin 2019
- Sasia e ujit të faturuar synohet të arrihet në 122 litër/ frymë/ditë në vitin 2023 nga 115 litër/ frymë/ditë në vitin 2019;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 24 orë/ditë në vitin 2023 nga 13 orë/ditë në vitin 2019;
- Reduktimi i humbjeve në rrjet në nivel kombëtar synohet të arrihet në 50% në vitin 2023 nga 62% në vitin 2019;
- Mbulimi me shërbimin e ITUN (kanalizime+gropa septike) synohet të arrihet në nivelin 17% në vitin 2022 nga 12% në vitin 2019;
- Përqindja e mbulimit të kostove të Ujësjetës-Kanalizimeve me të ardhurat synohet të arrihet në vlerën 90% në vitin 2023 nga 75% në vitin 2019;
- % e mbulimit të popullatës me ujëmatës duke shmangur kështu faturimin aforfe nga 59.18% në vitin 2013 në 94% në vitin 2023.

Ky program është buxhetuar në total 12.7 miliard lekë, ndërkohë që nevoja reale llogaritet 15.1 miliard lekë, pra janë plotësuar 85% e nevojave.

Për këtë arsye kërkohet rritje e tavanit të shpenzimeve kapitale me të paktën 2 miliard lekë për të mbuluar financimin e projekteve ekzistuese që përmbillen në vitin 2021.

- **Planifikimi Urban**

Programi ka si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale me 30%, deri në fund të vitit 2021, për garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit.

Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi, hartimi i një masterplani për të gjithë territorin e vendit, sa i përket venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, në bashkëpunim me partnerë të huaj, hartimi i rregullave dhe standarteve të projektimit në disa fusha

Ky program është buxhetuar në total 353.1 milion lekë dhe plotëson pothuajse të gjitha nevojat e parashikuara.

- **Mbështetje për Industrinë**

Ky program ka për qëllim zhvillimin e sektorit të industrisë jo ushqimore përmes promovimit dhe nxitjes së interesit të biznesit për mundësi zhvillimi të veprimtarive industriale, si dhe rritjen e shkallës së përpunimit në vend të burimeve natyrore, me synim rritjen e kontributit në GDP, eksport dhe punësim, për tërheqjen e investitorëve vendas e të huaj, likuidimin dhe mbylljen e ish ndërmarrjeve industriale, rehabilitimin e disa territoreve, si dhe objekteve ish industriale, rritjes së sigurisë të produkteve / pajisjeve / instalimeve dhe reduktimit të aksidenteve në punë dhe në miniera, rritjes së cilësisë së standardeve në treg të produkteve të naftës dhe gazit, minimizimin e rrezikut nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe subjekteve publike në varësi të MIE, administrimin e landfillëve me mbetje të rrezikshme të arsenikut në ish Uzinën e Plehrave Azotike Fier, ish PVC Vlorë.

Disa nga objektivat e këtij programi janë si më poshtë:

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspektimin dhe mbikqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE;
- Rritja e standardeve të produkteve dhe sigurisë së pajisjeve / instalimeve me 7% deri në vitin 2023
- Nxitja e interesit të biznesit vendas dhe të huaj për mundësi zhvillimi veprimtarish industrial;
- Reduktimi i rrezikut nga kimikatet e rrezikshme me 13% deri në vitin 2023.
- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;
- Rritja dhe përmirësimi i standardeve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme nën përgjegjësinë e MIE-s, në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme;
- Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim si parqe industriale;
- Rritja e mumrit të mostrave të analizuara të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend dhe të importuara në masën deri në 9200 në vitin 2023;

Ky program është buxhetuar në total 406 milion lekë dhe plotëson pothuajse të gjitha nevojat, megjithatë Ministria sqaroi deputetët se nuk plotësohen nevojat reale për shpenzimet korrente si më poshtë:

- ISHTI për shpenzime personeli për arsye të shtimit të organikës që është në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.105, datë 13.08.2020 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial" me 200 punonjës total;
- QGTKRR për shpenzime personeli.

Për këtë arsye u kërkua një rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me 5 milion lekë.

- **Mbështetje për Burimet Natyrore**

Ky program ka për qëllim nxitjen e rritjes së sektorit përmes promovimit dhe inkurajimit të zbulimit të burimeve të reja potenciale mineralmbajtëse, përmes kompanive vendase e të huaja, të vogla dhe të mesme, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional dhe efektiv të pasurive minerale, monitorimit minerar dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit etj.

Ky program është buxhetuar në total 262 milionë lekë ndërkohë që Ministria sqaroi deputetët që nevoja reale që llogaritet në 783 milion lekë dhe konkretisht këto mungesa janë si më poshtë:

- ka një pakësim të shpenzimeve korrente, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetin dhe mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni.
- buxheti për ndërmarrjet në konservim që janë Albminera, Albakër Alkrom, nuk mbulon nevojat reale për këto ndërmarrje gjë e cila ka berë që të krijohen detyrime të mbartura në paga, sigurime shoqërore e tatime në këto ndërmarrje.

Për këto arsye kërkohet:

- **rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me 5 milion lekë;**
- **rritje e tavanit për shpenzimet kapitale me të paktën 50 milion lekë.**

- **Planifikim Menaxhim Administrim**

Ky program mbulon financimin e shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës së tyre.

Ky program është buxhetuar në total 503.5 milion lekë nga nevoja reale që llogaritet 558 milion lekë.

Ministria sqaroi deputetët se në zerin kosto lokale është pasqyruar Asistenca teknike "Zhvillimi i nfrastrukturës digjitale rajonale", projekt që duhet të sistemohet në programin "Mbështetje për rrjetet e komunikimit", program i ri buxhetor krijuar në muajin shtator të vitit 2020.

Për këtë arsye kërkohet një rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me të paktën 50 milion lekë.

- **Mbështetje për rrjetet e Komunikacionit**

Ky programi i ri buxhetor i është referuar nevojës për përmirësimin e mbulimit me Internet dhe broadband, evidentuar dukshëm gjatë kohës së pandemisë në vështirësitë e lidhjes për zhvillimin e mësimin online sidomos në zonat rurale.

Ky program është buxhetuar 0 lekë ndërkohë që nevoja për të llogaritet në shumën 121.4 milion lekë.

Ministria sqaroi deputetët se në projektligjin e buxhetit 2021 për këtë program nuk janë parashikuar fonde buxhetore.

Për këtë arsye kërkoi shtimin e fondeve për:

- **Tavan buxhetor për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 2.4 milion lekë;**
- **Tavan buxhetor për shpenzime kapitale me financim të huaj në vlerën 20.1 milion lekë.**

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2021 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u përqëndruan kryesisht në:

- mbulimin me financim për projekte të ndryshme infrastrukture;
 - parashikimin e një fondi të veçantë për digjitalizimin;
 - menaxhimin e mbetjeve urbane dhe problematikat e tyre si në grumbullim, venddepozitime apo incineratorë;
 - ecurinë e Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe ndikimi që pritet nga funksionimi i saj në përmirësimin e treguesve të energjisë;
 - problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujęsjellës – kanalizime dhe përfitimi i zonave rurale prej tyre;
 - investimet në sektorin e energjisë dhe diversifikimin e burimeve të energjisë;
 - ecurinë e linjave të interkoneksionit në ndërtim;
- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 22 nene.

- ***Përfundime***

Gjatë diskutimeve, deputetët pasi u njohën me nevojat buxhetore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe për ato çështje për të cilat ngriti nevojën për t'u mbështetur me fonde, u shprehën të gatshëm që t'i trajtojnë ato gjatë shqyrtimit nën për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2021 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më 10.11.2020

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”

(shqyrtimi nen për nen)

I. Hyrje

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, në mbledhjen e datës 10 nëntor 2020. Mbledhja u zhvillua në platformën virtuale Cisco Webex.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të vitit 2021, ishin përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Balluku e përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie, si dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

II. Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

Gjatë shqyrtimit nen për nen Komisioni u njoh më konkretisht me kërkesat e Ministrive të mësipërme dhe duke i konsideruar si të nevojshme për mbarëvajtjen e punës në sektorët që mbulojnë këto ministri vendosi që disa prej tyre t’i paraqesë si rekomandime duke ia paraqitur për tu konsideratë të mëtejshme Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe disa prej tyre t’i miratojë.

- **Rekomandime për Komisionin përgjegjës**

Komisioni duke vlerësuar si shumë të nevojshme kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, vendosi t'i rekomandojë Komisionit Përgjegjës marrjen në konsideratë të kërkesave si më poshtë:

1. Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Komisioni rekomandon një shtesë financimi prej 350 milionë në programin (04250) Zhvillimi Rural në zërin Skema Kombëtare.
2. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni në përgjigje të shqetësimit të Ministres Balluku për moskrijimin e detyrimeve të prapambetura, rekomandon si më poshtë:
 - Programi “Transporti Rrugor” duke qenë se mungesa e financimit në politikat ekzistuese, projektet e të cilave mbyllen në vitin 2020 dhe 2021, do të rrisë ndjeshëm rrezikun për krijimin e detyrimeve buxhetore përgjatë vitit 2021 në programin e transportit rrugor, që aktualisht për vitin buxhetor 2020 do të përmbillet me një performancë shumë të mirë të shlyerjes së këtyre detyrimeve, rekomandon:
 - ✓ rritjen e tavanit buxhetor në shpenzimet korrente me 2 miliard lekë për të mbuluar nevojën reale të mirëmbajtjes së rrugëve;
 - ✓ rritjen e tavanit të shpenzimeve kapitale me të paktën 10 miliard lekë për të mbuluar financimin e projekteve ekzistuese që përmbillet në vitin 2021.
 - Programi “Transporti Detar”, Komisioni rekomandon marrjen në konsideratë për shtesë incestimesh në projekte të cilat lidhen drejtpërdrejtë me sistemet e menaxhimit të sigurisë në porte, dhe për të cilat MIE ka detyrime ndaj organizmave ndërkombëtare ku aderon, si më poshtë:
 - ✓ Shtesë tavani buxhetor me të paktën 200 milionë lekë për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për projektet e propozuara që nuk janë marrë parasysh në projektligjin e buxhetit;
 - ✓ Shtesë tavani të shpenzimeve kapitale me financim të huaj me të paktën 10 milion lekë lekë
 - Programi “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime”, duke qenë se mungesa e financimit në politikat ekzistuese, projektet e të cilave mbyllen në vitin 2020 dhe 2021, do të rrisë ndjeshëm rrezikun për krijimin e detyrimeve buxhetore përgjatë vitit 2021 në këtë program, që aktualisht për vitin buxhetor 2020 do të përmbillet me një performancë shumë të mirë të shlyerjes së këtyre detyrimeve, rekomandon:
 - ✓ Rritjen e tavanit të shpenzimeve kapitale me të paktën 2 miliard lekë për të mbuluar financimin e projekteve ekzistuese që përmbillet në vitin 2021.
 - Programi “Mbështetje për Industrinë”, duke qenë se ky program nuk plotëson nevojat reale për shpenzimet korrente lidhur me ISHTI-n për shpenzime personeli për arsye të shtimit të organikës me 200 punonjës total dhe për shpenzime personeli për QGTKRR-në, rekomandon:
 - ✓ rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me 5 milion lekë.
 - Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”, duke qenë se në zërin kosto lokale është pasqyruar Asistenca teknike “Zhvillimi i infrastrukturës digjitale rajonale”, projekt që

duhet të sistemohet në programin “Mbështetje për rrjetet e komunikimit”, program i ri buxhetor krijuar në muajin shtator të vitit 2020, rekomandohet:

✓ rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me të paktën 50 milion lekë;

3. Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni rekomandon sa më poshtë:

- Programi për mbrojtjen e Mjedisit
 - ✓ shtesë investimi në shumën 327 milionë lekë;
- Programi për Administrimin e Pyjeve
 - ✓ shtesë investimesh në shumën 280 milionë lekë;
- Programi Zhvillimi i Turizmit
 - ✓ shtesë investimesh në shumën 629 milionë lekë;
- Programi Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
 - ✓ shtesë shpenzimesh korrente (602) në shumën 210 milionë lekë.

• **Amendamente për Komisionin Përgjegjës**

Komisioni vendosi të miratojë kërkesat e mëposhtme sipas ministrive:

1. Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miratoi një shtesë financimi në programin 04240 “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes” në shumën e 430 milionë lekëve. Kjo për shkak të realizimit të përfundimit e rehabilitimit të skemave ujitëse, projekt që përfundon në muajin maj 2021.
2. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përgjigje të shqetësimeve të ngritura nga Ministria Znj. Balluku, Komisioni vendosi të miratojë kërkesat e mëposhtme:
 - Programi “Mbështetje për Energjinë”, duke qenë se Agjencia për Eficencën dhe Energjinë është në proces të miratimit të strukturës së re, si dhe për shkak të rëndësisë që ka funksionimi i kësaj agjencie në kuadër të menaxhimit të energjisë dhe kontributet që pritet të japë në disa projekte të rëndësishme si: Projekti për ngrohjen e qytetit të Korçës në masën 85% nga burime të rinovueshme; Projekti për rikualitimin e bllokut parafabrikat për realizimin e konceptit të efikasitetit të energjisë; Projekti për vendosjen e pajisjeve fotovoltaike në ndërtesat e institucioneve që merren me energjinë; etj, Komisioni vendosi të miratojë:
 - ✓ rritjen e tavanit të shpenzimeve korrente në shumën 64.5 milion lekë.
 - Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”, duke qenë se ka një pakësim të shpenzimeve korrente, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetin dhe mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni, si dhe duke qenë se buxheti për ndërmarrjet në konservim që janë Albminera, Albakër Alkrom, nuk mbulon nevojat reale për këto ndërmarrje gjë e cila ka berë që të krijohen detyrime të mbartura në paga, sigurime shoqërore e tatime në këto ndërmarrje, Komisioni vendosi të miratojë:
 - ✓ rritje e tavanit buxhetor për shpenzimet korrente me 5 milion lekë;
 - ✓ rritje e tavanit për shpenzimet kapitale me të paktën 50 milion lekë.

- Programi “Mbështetje për rrjetet e Komunikacionit” duke qenë se në projektligjin e buxhetit 2021 për këtë program nuk janë parashikuar fonde buxhetore, dhe për t’i dhënë vëmendjen e duhur këtij programi në mënyrë që t’i hapet rruga për të aplikuar për fonde të BE-së, Komisioni vendosi që ky program të ketë:
 - ✓ tavan buxhetor për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 2.4 milion lekë;
 - ✓ tavan buxhetor për shpenzime kapitale me financim të huaj në vlerën 20.1 milion lekë.

3. Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioni vendosi:

- Programi për mbrojtjen e Mjedisit, artikulli “Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend depozitimeve ekzistuese” të miratojë një shtesë investimi prej 300 milionë lekësh.
- Programi Zhvillimi i Turizmit, artikulli “Promovimi i turizmit dhe organizimi i panairove” të miratojë shtesë shpenzimesh korente prej 90 milionë lekë.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, Komisioni i propozon komisionit përgjegjës që:

- **Në nenin 11,**
 - në paragrafin e katërt fjalët “dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme” të zëvendësohen me fjalët “vitet fiskale 2018, 2019, 2020,2021 dhe 2022”;
 - në paragrafin e fundit fjalët “të vitit korent” të zëvendësohen me fjalët “të vitit 2020”;
 - pas paragrafit të fundit të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit të caktuar në Programin e Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedura dhe mënyra e administrimit të fondit përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.”
- **Në nenin 21,**
 - të vendosen referencat e neneve në zbatim të të cilave të detyrohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxjerrë udhëzime për zbatimin e ligjit të buxhetit 2021, si dhe afatet përkatëse.
 - në rast miratimi të amendamentit të propozuar në nenin 11, të parashikohet një pikë e dytë për ngarkimin e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e vendimit në zbatim të paragrafit të fundit të nenit 11, si dhe një pikë të tretë për nxjerrjen e udhëzimit të ministrit përgjegjës për bujqësinë po në zbatim të këtij paragrafi.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, vendosi miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Arben PELLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar

